

VENDIM
Nr. 195, datë 9.3.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 274, DATË 12.6.1993, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KOMPENSIMIN PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA
RRITJA E ÇMIMIT TË BUKËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2, të kapitullit I, të vendimit nr. 274, datë 12.6.1993, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqen fjalët “...si dhe atyre që do të përfitojnë pagesë papunësie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi